

**Konventa Kombëtare për Integrimin Europian
dhe
Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian
Kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore**

**GDPR dhe zbatimi - efektet dhe implikimet në legjislacionin kombëtar dhe kuadrin
institucional**

E premte, 08 Korrik 2022, 10:00 – 12:00

Një projektligj është përgatitur dhe po konsultohet në lidhje me Mbrojtjen e të Dhënave Personale me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, me qëllim që qytetarëve t'u ofrohen standardet më të larta europiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Ky projektligj i ri vjen si domosdoshmëri pasi kuadri ligjor shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk është i përafuar me GDPR ndërkohë që kjo është një element prioritar për të garantuar sigurinë e të dhënave personale.

Ky detyrim ka ardhur dhe nga Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2020, i cili ndër të tjera thekson se: "Lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, nevojiten përpjekje të mëtijshme për të harmonizuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680". Bazuar në këtë rekomandim të Komisionit, harmonizimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë është parashikuar dhe nga Plani Kombëtar i Integritimit Europian 2022 – 2024, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022.

*Siç është përcaktuar dhe në relacionin shpjegues bashkëlidhur projektligjit disa nga objektivat janë: harmonizimi me *acquis communautaire*, zbatimi i standardeve të BE në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, rritja e "përgjegjshmërisë" së kontrolluesve dhe përpunuesve në procesin e përpunimit të të dhënave personale, mbikëqyrja efektive për zbatimin të këtij legjislacioni, si dhe përfshirja e Shqipërisë në listën e shteteve për të cilat Komisioni Europian përcakton se ofron sistem të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.*

REKOMANDIME

- Në kuadër të hartimit dhe miratimit të një projektligji të ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është kriter kryesor përafrimi me parimet e GDPR si Rregullorja e BE që ka njehsuar mbrojtjen e të dhënave në nivel të Bashkimit Europian. Disa nga këto parime janë: - neutraliteti teknik, - parimi i përgjegjshmërisë, - parimi i proporcionalitetit gjithashtu dhe një

numër më i madh të drejtash që janë përfshirë. Për këtë projektligji dhe aktet nënligjore që do të realizohen duhet të marrin në konsideratë që të respektojnë të gjitha këto parime dhe të arrijnë një zbatim sa më efektiv të saj.

- Sugjerohet gjithashtu që gjatë hartimit dhe të akteve nënligjore si dhe gjatë zbatimit të minimizohen sa më shumë devijimet apo mospërputhjet me GDPR dhe ato mund të ndodhin vetëm kur dhe GDPR e parashikon një gjë të tillë. Nga ana tjetër rekomandohet që dhe ligje të tjera që hartohen jo specifikisht për këtë fushë të referojnë dhe të përshtaten me GDPR duke qenë që në shumë veprimtari ekonomike, punësimin, edukimit, shëndetit apo informimit parashikohet mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale.
- Gjatë hartimit të ligjit por dhe akteve të tjera të lidhura me të sugjerohet që të merret në konsideratë që terminologjia e përdorur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor vendas ekzistues në mënyrë që të mos krijohen paqartësi.
- Bazuar në faktin që për zbatimin e këtij ligji dhe garantimin e të dhënave personale duke bërë përgjegjës për këtë jo vetëm institucionet publike dhe autoritetet përgjegjëse por edhe ato private e duke përfshirë të gjithë sektorët e shoqërisë (ekonomik e financiar, shoqëror, arsimor, punësimin etj.). Për këtë rekomandohet që të realizohen fushata informimi dhe shpërndarje më e gjerë e informacionit, dhe mund të parashikohen dhe trajnime apo aktivitete të tjera për rritje kapacitetesh si nga sektori publik dhe ai privat.
- Miratimi i projektligjit që përafrohet me GDPR, do të sjellë rrjedhimisht një sërë standardesh e kriteresh që duhen garantuar, që përkthehen ndër të tjera dhe në një dokumentacion më të gjerë e të detajuar që lidhen me mënyrën si mbledhen, përpunohen dhe publikohen të dhënat të tilla si marrëveshje për përpunimin e të dhënave, njoftime për privatësinë, regjistrimi i aktiviteteve përpunuese, rregullore të brendshme, vlerësime të procesit dhe autorizime përkatëse. Për këtë rekomandohet që dokumentacioni të jetë sa më i plotë dhe i qartë për të gjitha palët dhe aktorët përgjegjës të orientohen që ta ndjekin këtë procedurë dhe për rëndësinë që ky dokumentacion ka për respektimin e ligjit dhe zbatimin e plotë të tij.
- Duke qenë që projektligji ashtu si dhe GDPR prezantojnë një set të drejtash për qytetarët, dhe disa prej tyre janë të reja dhe pak të njohura për qytetarët shqiptarë rekomandohet që të realizohen fushat ndërgjegjësimi dhe informimi të gjerë me kategori të ndryshme qytetarësh ku të informohen për të drejtat e tyre e si garantohen ato në kuadër të mbrojtjes dhe përpunimit të të dhënave personale duke i qartësuar mbi procedurat që mund të ndiqen dhe institucionet përgjegjëse.
- Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet pjesës së informimit mbi procedurën dhe autoritetet përgjegjëse në rast të shkeljes së të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, që qytetarët e prekur të jenë të qartë ku duhet të ankohen dhe cila është procedura që mund të ndjekin në

raste të tilla të shkeljes së të drejtave të tyre.

- Sugjerohet një bashkëpunim më i ngushtë mes institucioneve publike përgjegjëse si Komisioneri për Mbrojtjen dhe Ministria e Drejtësisë me sektorin e shoqërisë civile që mund të shërbejë si në marrjen e nismave dhe aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, ashtu dhe të ofrojnë ekspertizë dhe mbështetje teknike në realizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve që synojnë ngritjen e kapaciteteve.
- Autoriteti përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave, që në Shqipëri është Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave duhet të intensifikojë punën e tij duke u fokusuar në këto tre përgjegjësi kryesore për të bërë të mundur që ligji të zbatohet në mënyrë sa më efektive: 1) të monitorojë në çdo fazë zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave, 2) të ofrojë orientime mbi procedurën e përpunimit të të dhënave, 3) të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi të drejtat e qytetarëve dhe detyrimeve të operatorëve si publikë dhe atyre privatë, mbi garantimin e sigurisë së të dhënave të mbledhura e të përpunuara.